

Fjalim i deputetit Petrit Vasili

03.07.2023

Zonja drejtuese e seancës, Unë nuk e kuptoj dot se çfarë merr përsipër

Konferenca e Kryetarëve, sepse po në këtë sallë për komisione të pavarura koha ndryshon siç do Konferenca e Kryetarëve.

Jo më larg se javët e shkuara, kemi pasur një kohë të caktuar, konkretisht, një 5-minutësh për secilin raport, ndërsa sot diskutohen pesë raporte dhe kemi në dispozicion vetëm 10 minuta.

Tani, nga një javë përpara, në një javë më mbrapa, çfarë është kjo Konferencë Kryetarësh, bën pazarin e gjësë, apo është një institucion serioz, e para?

E dyta, asnjë kompetencë nuk ka Konferenca e Kryetarëve të bashkojë, të rregullojë e t'i bëjë si një grumbull i madh diskutimi, por ka detyrimin që për secilin institucion të raportohet një për një dhe të ketë një rezolutë të pavarur, sepse secili ka fushën e veprimtarisë së tij dhe secili duhet të japë llogari në Kuvend deri më një për atë fushë veprimtarie që mbulon.

Ky kooperativizim i diskutimit është për të mos u shkuar as përgjegjësive dhe as të vërtetave deri në fund, por për të mbajtur një klimë status quo-je, se ashtu i intereson dhe ashtu i pëlqen mazhorancës.

E treta, meqenëse ju këtu e përmendni Rregulloren vazhdimisht pa u lodhur, dhe mirë bëni, por jo të përmendet Rregullorja ashtu siç doni ju dhe kur të keni qejf ju; mënyrën se si e vendosët ju, që të mos bëni seanca, nuk e shkruante Rregullorja në asnjë vend.

Ju vendosni që ditën e hënë, që është përcaktuar nga neni 40 si dita ku diskutohet për 4 orë për problemet e zgjedhësve, t'i diskutoni bashkë këto çështje, dhe problemet e zgjedhësve, për të cilat diskutohet në një ditë të vetme, e përcaktuar kjo në Rregullore (e rregulluar, e moderuar Rregullorja për së pari), diskutohen në fund dhe improvizohet një debat i tillë.

Kështu që, kthimin e kësaj salle në një pjesë ku luhet ajo që është pështirosja e Konferencës së Kryetarëve, mos na e shisni për Rregullore, por qëndrojeni Rregullores deri në fund në të gjitha llojet e elementeve, qoftë edhe në kohën e saj!

Pak më parë harruat që t'i monitoronit këto, ndërkohë që diskutimi nuk ka filluar dhe flitet vetëm për procedurë. Në këtë sallë nuk duhet të ketë të privilegjuar, pavarësisht kush ju vendos juve atje lart. Rregullorja është mbi të gjithë ne, na bën të barabartë të gjithëve, kurse votimi na ndan.

Kjo situatë, kjo skemë, që disave u jepni vërejtje për dalje nga rendi i ditës, ndërkohë që të tjerët flasin për gjëra që nuk kanë fare lidhje me rendin e ditës, por kanë privilegjin që janë pjesë e mazhorancës, është e turpshme.

Kështu që, jepini fund drejtimit të seancës me dy standarde, një për tuajit dhe një për të tjerët, sepse, për fat të mirë, seanca është e hapur dhe jemi përpara syve të njerëzve.

Ju mund të thoni “punë e madhe”, por nuk është ashtu, sepse Rregullorja është Kushtetuta e Kuvendit.